



### Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Monitorues i Programit 'Hap pas Hapi'
Kodi i procedurës së rekrutimit	EU SIMRAES2-001
Emërtimi i projektit ose programit	Përkrahja e BE-së për zbatimin strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2- arsim për integrim (EU SIMRAES 2)
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	A 1.4.2 – Monitorimi i fasilituesve dhe tutorëve të qendrave mësimore.
#ditëve të punës	35
Periudha e angazhimit	1 shtator 2018 – 31 mars 2019

#### Qëllimi i konsulencës

Montiruesi i programit HpH do të angazhohet për të realizuar vizitat monitoruese mbledhjen e të dhënave në terren dhe ofrimin e këshillave profesionale për stafin e qendrave mësimore në katër (4) qendra mësimore në tri (3) komuna të Kosovës.

#### Përshkrimi i projektit

Projekti për mbështetje të zbatimit të strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2 – Arsim për Integrim (shih më tutje: EU SIMRAES 2), ka filluar implementimin me 1 prill 2016. Projekti EU SIMRAES 2 implementohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me 6 partnerë lokalë<sup>1</sup>.

#### Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

Qëllimi i angazhimit të monitoruesit të programit HpH është:

- Përgatitja e planit të vizitave monitoruese në qendra mësimore;
- Krijimi i raporteve të mira të komunikimit dhe bashkëpunimit me stafin e qendrës mësimore/shkollës;
- Evidentimi i pjesëmarrësve të intervistuar dhe kontaktuar gjatë monitorimit;
- Shpërndarja e materialeve të nevojshme të projektit rreth programit HpH/EDSH;
- Mbledhja e informatës kthyes nga të intervistuarit, në formë të vlerësimit ose në forma të tjera të përshtatshme;
- Hartimi i raportit të monitorimit për rrjedhën e vizitës në qendër mësimore;
- Përgatitja e raportit të analizës dhe mësimave të nxjerra në fund të vitit të projektit;
- Dorëzimi i raportit dhe dokumentacionit të monitorimit tek menaxheri përgjegjës;
- Kryerja e punëve të tjera me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së monitorimit me kërkesën e menaxherit përgjegjës.

<sup>1</sup> Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Bethany Christian Services (BCS), Nevo Koncepti (NVK), SHL Kosova (SHL-K), Syri i Vizionit (SiV), Qendra për Dokumentim të Romëve dhe Ashkalive (RADK)





### Fushat kryesore për vëzhgim janë:

- Planifikimi dhe të nxënës ditor
- Puna e përditshme e fasilituesve dhe tutorëve dhe bashkëpunimi i tyre.
- Materialet e përdorura për aktivitete
- Qendrat e aktiviteteve dhe vendosja e tyre
- Raporti i stafit të Qendrave Mësimore me prindërit dhe shkollën
- Mësimi individual/i diferencuar
- Higjiena, kushtet e mësim, etj.

### Rezultatet e pritshme

- Caktohen takime me Koordinatorët dhe stafin e Qendrave Mësimore, stafin e shkollës, prindërit dhe palët tjera të interesit.
- Zhvillohen takime/intervista të ndryshme me qëllim të mbledhjes së informatave mbi implementimin e programeve në qendra mësimore.
- Raportohen të dhënat e mbledhura sipas formave të zhvilluara të raportimit dhe udhëzimeve të dhëna nga Menaxheri i Projektit.
- Dorëzohen raportet për të gjitha vizitat respektivisht monitorimet.

### Kualifikimet

- Përgatitje superiore shkollore ose përvojë 3-vjeçare në fushën e projekteve në arsim.
- Shkathtësi të shkëlqyera të komunikimit, përfshirë aftësinë për të komunikuar arsyen e vizitave monitoruese dhe mbledhjen e të dhënave.
- Përvoja e mëhershme me natyrën e punës së qendrave mësimore
- Të ketë të përfunduar trajnimin e HqH
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, në të folur dhe shkruar në gjuhën shqipe.
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike, me qëllim të organizimit të punës.
- Etikë profesionale gjatë kryerjes së monitorimeve/vizitave.

### Raportimi

Konsulenti i raporton Menaxherit të Projektit – Drilon Krasniqi

